

NATO Office on Gender Perspective (NOGP)

NATO HQ/IMS

Boulevard Leopold III

B-1110 Brussels

Fax: 32-2-707-5988

Email: dims.win@hq.nato.int

RAPORT KOMBËTAR 2013

“PERSPEKTIVA GJINORE NE FORCAT E ARMATOSURA SHQIPTARE”

Ky raport është një panoramë e përfshirjes së femrave në Forcat e Armatosura Shqiptare (FASH) për vitin 2013 dhe iniciativat e ndërmarra për forcimin e kapaciteteve dhe perspektivës gjinore institucionale.

1. Politikat (ndryshime të politikave/politikave të reja që lidhen me gjininë)

a. Ndryshime të politikave ose iniciativat në pritje, që përfshijnë legjislacionin, rregulloret dhe shërbimet në lidhje me punësimin e grave dhe menaxhimin e personelit ushtarak.

- Dokumenti bazë që mbron liritë dhe të drejtat themelore të individit në Republikën e Shqipërisë (RSH) është “Kushtetuta e RSH”. Ajo sanksionon parimin e barazisë si parim themelor dhe si kusht të domosdoshëm për mbarëvajtjen e të gjithë veprimtarisë së organeve shtetërore dhe nuk lejon asnjë formë të diskriminimit të individit (Kushtetuta e RSH, neni 18, pika 1 dhe 2).
- Dokument tjetër i rëndësishëm është “Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri” (nr. 9970, dt. 24.07.2008), bazohet në parimin e barazisë dhe të mos diskriminimit dhe në parimet e tjera të sanksionuara nga Kushtetuta; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAË); si dhe nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga RSH (neni 3, pika 1).
- “Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2011-2015”, ka për qëllim të ndikojë në përmirësimin e pozitës së grave në shoqërinë shqiptare dhe të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm në gjini. Për sa i takon FASH, ky dokument ka si objektiv kryesor hartimin e politikave institucionale për rritjen e pjesëmarrjes së femrave në operacionet paqeruajtëse, në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, si dhe nxitjen e iniciativave inkurajuese për përfshirjen më të gjerë të tyre në proceset dhe pozicionet vendimmarrëse.
- “Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në FA, 2011-2013”, përcakton kuotën 15% e personelit në FA duhet të jenë femra.
- “Direktiva e Mbrojtjes”, dokumenti themelor mbi të cilin mbështetet puna vjetore e FA, ka vendosur si prioritet hartimin e politikave gjinore dhe shanseve të barabarta.

b. Nisma dhe programe të zbatuara në bazë të Udhëzimit të CËINF për perspektivën gjinore.

http://www.nato.int/issues/eomen_nato/cwinf_guidance.pdf

- Gjatë vitit 2012 u formua Sektori i Shanseve të Barabarta, në Qendrën e Personel-Rekrutimit të FA. Misioni kryesor i tij është monitorimi i zbatimit të ligjeve, akteve ligjore/nënligjore

(urdhra, udhëzime etj) dhe dokumenteve politikë lidhur me respektimin e shanseve të barabarta për çdo qytetar që fiton te drejtën të bëhet pjesë e FASH, pa dalluar dhe diskriminuar askënd.

- Me mbështetjen e Përfaqësisë së UN Women në Tiranë, FA kanë realizuar fazën e parë të trajnimeve bazë “Barazia gjinore dhe implementimi i Rezolutës 1325 të UNSCR”. Me mbështetjen e kësaj organizate është ngritur një grup ToT, i cili është trajnuar për çështjet gjinore; dhunën seksuale dhe rolin e femrave në misione dhe në operacionet e paqes, gjatë dhe pas konflikteve të armatosura.
- Në bashkëpunim dhe me mbështetjen e DCAF (Qendra për Kontrollin Demokratik në FA), me seli në Gjenevë dhe me Përfaqësinë e UN Women në Tiranë, ka filluar implementimin e projektit studimor “Vetëvlerësimi gjinor në FARSH”. Ky studim do të adresojë problemet dhe do të shërbejë si dokument i rëndësishëm referues për përmirësimin e politikave në kuadër të barazisë gjinore, promovimit të femrave ushtarake në gradë dhe karrierë dhe përfshirjen më të gjerë të tyre në misione dhe operacione paqeruajtëse.
- Tashmë rrjeti i Pikave të Kontaktit për barazinë gjinore është rrjet që funksionon dhe mbështet çdo iniciativë që ndërmerret në këtë kuadër. Ky rrjet është trajnuar lidhur me çështjet gender dhe është pjesë e grupit të punës, për realizimin e projektit studimor “Vetëvlerësimi gjinor në FARSH”.
- FASH janë të interesuara për zgjerimin e bashkëpunimit me vendet aleate dhe ato partnere për marrjen e ekspertizës në fushën e perspektivës dhe barazisë gjinore dhe në forcimin e kapaciteteve për implementimin e Rezolutës 1325 të KS të OKB.

2. Personeli Femër në Forcat e Armatosura Shqiptare

NATO UNCLASSIFIED RELEASABLE TO THE PUBLIC

Forcat e Armatosura Shqiptare

Personel aktiv ushtarak	Tot. %	Total nr.	% nga OF-6 dhe më lart	Nr nga OF-6 dhe më lart	% nga OF-3 në OF-5	Nr nga OF-3 në OF-5	% nga OF-1 në OF-2	Nr nga OF-1 në OF-2	% nga OR-5 në OR-9	Nr of OR-5 to OR-9	% nga OR-1 në OR-4	Nr nga OR-1 në OR-4
Forca Tokësore	9.2	217	-	-	9.3	9	16.6	49	10	106	5.7	53
Forca Ajrore	14.7	76	-	-	2	4	11	22	17.5	39	12	11
Forca Detare	9.64	54	-	-	13.8	5	10.8	10	10.2	31	4.1	8
TOTAL	11.2	357	-	-	8.4	18	12.8	81	12.6	176	7.3	72

Operacionet në kuadër të NATO-s

Personel aktiv ushtarak	Tot. %	Total nr.	% nga OF-6 dhe më lart	Nr nga OF-6 dhe më lart	% nga OF-3 në OF-5	Nr nga OF-3 në OF-5	% nga OF-1 në OF-2	Nr nga OF-1 në OF-2	% nga OR-5 në OR-9	Nr of OR-5 to OR-9	% nga OR-1 në OR-4	Nr nga OR-1 në OR-4
Forca Tokësore	0.14	1	-	-	-	-	-	-	-	-	0.31	1
Forca Ajrore	0	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Forca Detare	0	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTAL	0.14	1	-	-	-	-	-	-	-	-	0.31	1

NATO UNCLASSIFIED RELEASABLE TO THE PUBLIC

NATO UNCLASSIFIED RELEASABLE TO THE PUBLIC

Operacionet në kuadër të EU

Personel aktiv ushtarak	Tot. %	Total nr.	% nga OF-6 dhe më lart	Nr nga OF-6 dhe më lart	% nga OF-3 në OF-5	Nr nga OF-3 në OF-5	% nga OF-1 në OF-2	Nr nga OF-1 në OF-2	% nga OR-5 në OR-9	Nr of OR-5 to OR-9	% nga OR-1 në OR-4	Nr nga OR-1 në OR-4
Forca Tokësore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Forca Ajrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Forca Detare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTAL	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Operacione në kuadër të UN

Personel aktiv ushtarak	Tot. %	Total nr.	% nga OF-6 dhe më lart	Nr nga OF-6 dhe më lart	% nga OF-3 në OF-5	Nr nga OF-3 në OF-5	% nga OF-1 në OF-2	Nr nga OF-1 në OF-2	% nga OR-5 në OR-9	Nr of OR-5 to OR-9	% nga OR-1 në OR-4	Nr nga OR-1 në OR-4
Forca Tokësore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

NATO UNCLASSIFIED RELEASABLE TO THE PUBLIC

NATO UNCLASSIFIED RELEASABLE TO THE PUBLIC

Forca Ajrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Forca Detare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTAL	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

NATO UNCLASSIFIED RELEASABLE TO THE PUBLIC

3. Barazia gjinore në operacione

FASH nuk kanë në strukturën e tyre këshilltar për çështjet gjinore. Ministria e Mbrojtjes, ka një Nëpunës Gjinor, civile femër, në cilësinë e ekspertit për çështjet gjinore në Forcat e Armatosura, emëruar në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore në Shoqëri dhe Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje. Nëpunësi Gjinor përveç edukimit të duhur akademik, ka edhe një ekspertizë të gjerë në fushën e barazisë gjinore dhe është trajnuar për çështjet e barazisë gjinore, legjislativitetit lidhur me të, çështje të dhunës, të ngacmimeve seksuale, të Rezolutës 1325, 1820 dhe rezolutave shtesë të KS të OKB.

Trupat ushtarake që Shqipëria dërgon në misione dhe operacione luftarake, në fazën e tyre parapërgatitore trajnohen ndër të tjera edhe për çështjet gender, duke iu referuar specifikave të veçanta të vendit ku do të dislokohen, kulturës dhe traditave të tyre.

Numri i përfshirjes së femrave ushtarake në misionet paqeruajtëse është i vogël. Gjatë vitit 2012, 1.2 % e trupave paqeruajtëse ka qenë femra.

Çështjet e Barazisë Gjinore janë përfshirë në Planin Operacional dhe atë të Stërvitjes. Para se të nisen në mision, trupat ushtarake trajnohen për çështjet që lidhen me dhunën më bazë gjinore, dhunën seksuale dhe rezolutën 1325 dhe të KS të OKB.

4. Trajnime kombëtare për çështjet e barazisë gjinore dhe zbatimin e Rezolutës 1325 dhe 1820

Nr	Trajnim/Edukim	Përshkrim i shkurtër/Tema kryesore	Grupet e synuara	Koha
1	Barazia Gjinore dhe implementimi i Rezolutës 1325	Ligji kombëtar dhe ndërkombëtar. Femrat në misione dhe operacione paqeruajtëse. Rezoluta 1325 e KS të OKB dhe rezolutat shtesë 1888, 1889, 1960	Spektori i Shanseve të Barabarta dhe Pikat e kontaktit të Barazisë Gjinore në strukturat e FASH	12-13.11.2012
2	Barazia Gjinore dhe implementimi i	Ligji kombëtar dhe ndërkombëtar.	Personel Ushtarak nga	14-

	Rezolutës 1325	Femrat në misione dhe operacione paqeriajtëse. Rezoluta 1325 e KS të OKB dhe rezolutat shtesë 1888, 1889, 1960	Batalioni Special, Forcat Ajrore dhe Forca Detare	15.11.2013

5. Informacione shtesë

Në bashkëpunim dhe me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare UN Women dhe DCAF, po punohet për hartimin e Planit të Veprimit për integrimin gjinorë në FA dhe zbatimin e Rezolutës 1325 “Gruaja, Paqja dhe Siguria”, të UNSCR.

6. Konkluzione

FASH kanë bërë progres të dukshëm në fushën e perspektivës gjinore e të zbatimit të detyrimeve që vijnë në kuadër të OKB dhe të NATO-s. Trajtimi i këtyre çështjeve është pjesë e prioriteteve të Direktivës së Mbrojtjes. Mbi këtë bazë, në dokumentet strategjike (politika e procedura) të hartuar deri tani, por dhe ato që do të hartohen në të ardhmen, çështjet gjinore do të jetë pjesë integrale e tyre, duke u fokusuar në:

- Përfshirjen e femrave në stërvitje të përbashkëta brenda e jashtë vendit
- Rritjen e numrit të femrave në misione dhe në operacionet e paqes
- Rritjen e numrit të femrave në sektorët e tjerë të sigurisë
- Nxitjen dhe promovimin në gradë e karrierë
- Hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe të rezolutave shtesë 1820, 1888, 1889 dhe 1960.

Aprovoi: Kolonel Albert Mullai
Drejtoria e Politikave dhe Planifikimit Strategjik
Drejtor
Email: albert.mullai@aaf.mil.al

Punoi: Mirela Rrumbullaku
Drejtoria e Politikave dhe Planifikimit Strategjik
Nëpunëse Gjinore/Specialiste
Email: mrrumbullaku@mod.gov.al

Datë, 18.03.2013

Ky dokument gjendet i publikuar në website-n e Ministrisë së Mbrojtjes:
<http://www.mod.gov.al/>
dhe në website-n e NATO-s:
http://www.nato.int/cps/en/SID-D84B3564-24CF822E/natolive/topics_50327.htm